



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 812/2 Prot

Tiranë, më 13.10.2023

V E N D I M

Nr.81, datë 13.10.2023

Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprime administrative të kryera gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Vlorë dhe paralajmërimi i institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Vlorë,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me nr. 812 prot., datë 24.07.2023, i paraqitur nga nëpunësi ***** me detyrë “Drejtor në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”, në Bashkinë Vlorë, përmes së cilit ngrihen pretendime për shkelje të dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë aplikimit të disa prej instituteve të tij.

Konkretisht, në përmbajtjen e informacionit të mësipërm parashtrohen pretendime, për zbatim të gabuar të legjislacionit të shërbimit civil, në këto drejtime:

a) Me vendimin nr. 132, datë 19.09.2022, “Për dhënie masë disiplinore punonjësve të Bashkisë Vlorë”, të kryetarit të bashkisë Vlorë, ndaj nëpunësit ***** me detyrë “Drejtor në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”, është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, pa dijeninë e nëpunësit për fillimin e procedurës disiplinore.

Sa i takon masës disiplinore të dhënë, nëpunësi ngre pretendimin se, nga ana e eprorit direkt nuk janë respektuar kërkesat e parashikuara në kreun X, “Disiplina në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe dispozitat e cituara në kreun II, “Procedura disiplinore”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, të detyrueshme për tu ndjekur nga ana e eprorit direkt, në rastin e zbatimit të institutit të disiplinës, në shërbimin civil.

Për këtë arsye, nëpunësi ***** me shkresën nr. 10552 prot., datë 20.09.2022, i është drejtuar eprorit direkt, ku ka kërkuar t’i vihet në dispozicion kopje e dokumentacionit të procedurës disiplinore të nisur në ngarkim të tij, për të cilën nuk ka marrë asnjë përgjigje.

b) Me shkresën nr. 1551 prot., datë 07.02.2023, “Njoftim për fillimin e procedurës disiplinore”, të nënshkruar nga Komisioni i Disiplinës, nëpunësi është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të tij, me motivacionin për shkelje të pretenduara të kryera nga nëpunësi, të evidentuara në Raportin përfundimtar, të KLSH-së, si dhe me të drejtën për të paraqitur me shkrim përpara Komisionit, sqarimet mbi shkeljet e pretenduara, brenda afatit 10 ditore, nga momenti i marrjes së njoftimit.

Sa më sipër, nëpunësi pretendon se, ka marrë pjesë në të gjitha seancat dëgjimore, për të cilat është njoftuar, por qëllimisht, disa herë për shkak të mungesës së të njëjtit anëtar të Komisionit Disiplinor, këto seanca janë shtyrë dhe për vërtetimin e këtij fakti, ka paraqitur aktet e njoftimit të Komisionit Disiplinor, ku evidentohen datat e seancave të shtyra.

Ndërkohë që, procedura disiplinore ishte ende në shqyrtim, pa pritur vendimin e Komisionit të Disiplinës, kryetari i bashkisë me vendimin nr. 60, (nr.6899 prot.), datë 12.06.2023, “Për lirimin nga shërbimi civil”, ka urdhëruar lirimin nga shërbimi civil, të nëpunësit ***** me motivacionin: mbështetur në rekomandimet e dhëna nga KLSH, si dhe për shkelje të rëndë të etikës institucionale, në Bashkinë Vlorë. Ky akt është i shoqëruar edhe me një relacion të nënshkruar nga kryetari i bashkisë, i cili mban të njëjtin numër protokolli dhe të njëjtën datë me aktin e lirimit.

Për më tepër, nëpunësi parashton se, vendimi i lirimit është nxjerrë qëllimisht në datën 12.06.2023, nga titullari, pasi, nëpunësi për periudhën 12.06.2023 deri në datën 11.07.2023, ka qenë i paaftë për t’u paraqitur në punë, fakt i provuar me raportet mjekësore të dorëzuara pranë institucionit.

c) Në momentin e marrjes dijeni për vendimin e lirimit, nëpunësit i është vënë në dispozicion, një formular i vlerësimit të punës, për periudhën 01.07.2022 deri 31.12.2022, ku është vlerësuar nga zyrtarët vlerësues, (që në këtë rast përkrijnë të gjitha nivelet me kryetarin e bashkisë Vlorë), me nivelin **4 (jokënaqshëm)**.

Në lidhje me këtë vlerësim, nëpunësi pretendon se, formulari i vlerësimit nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 06.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i cili miraton procedurën e hollësishme të vlerësimit të rezultateve në punë dhe kompetencat për vlerësimin.

Me qëllim hetimin e rastit, me marrjen e këtij informacioni, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, kryesisht, ka filluar procesin e verifikimit të ligjshmërisë së këtyre proceseve administrative. Në këtë kuadër, përmes e-mailit zyrtar, dërguar njësisë përgjegjëse, pranë institucionit të Bashkisë Vlorë, kërkoi sqarimet për rastin në fjalë, si dhe praktikën shkresore të disponuar, duke përfshirë dokumentacionin që materializon veprimet e kryera nga ana e institucionit.

Nga analiza e materialeve shkresore të administruara si dhe dokumentacioni bashkëlidhur informacionit të nëpunësit, situata evidentohet si më poshtë:

Së pari, në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së procedurës për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunësit ******, me Vendimin nr. 132, datë 19.09.2022, të kryetarit të bashkisë Vlorë, konstatohet se: në nenin 57, “Përgjegjësia për masat disiplinore”, përcaktohet përgjegjësia e nëpunësit civil për shkeljen me faj të detyrimeve sipas ligjit, si edhe kategorizimi i shkeljeve në:

- a) shkelje shumë të rënda; b) shkelje të rënda; c) shkelje të lehta.

Më tej, në pikën 2, të këtij neni, parashikohet kategorizimi i shkeljeve shumë të rënda; në pikën 3, i shkeljeve të rënda dhe në pikën 4, i shkeljeve të lehta.

Ndërsa, në nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, parashikohen “Llojet e masave disiplinore” të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, në një rast kur evidentohen shkelje disiplinore:

“Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë:

- a) vërejtje;*
- b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj;*
- c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.*
- ç) largim nga shërbimi civil”;*

dhe në nenin 59, të këtij ligji, përcaktohet kompetenca dhe procedura për dhënien e tyre. Sipas pikës 2, të kësaj dispozite, masa e parashikuar në germën a) të nenit 58, jepet nga eprori direkt i nëpunësit, ndërsa masat e parashikuara në germat b), c) dhe ç) jepen nga Komisioni Disiplinor, për çdo nëpunës civil në institucion.

Në referim të pikës 10, të nenit 59, të ligjit në fjalë, është parashikuar se, Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregullat e hollësishtme të procedurës disiplinore, si dhe rregullat për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor. Ky detyrim ka gjetur zbatim me miratimin e Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, i ndryshuar.

Konkretisht, në aktin nënligjor që rregullon disiplinën në shërbimin civil, (VKM nr.115/2014), në kreun I *“Organet Disiplinore”*, pika 1, përcaktohet se:

“Organet disiplinore, sipas ligjit, janë: Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes, për anëtarët e TND-së (KKP); komisioni disiplinor (KD), për nëpunësit e tjerë, dhe eprori direkt”.

Sa i takon procedurës që duhet të ndiqet nga ana e organeve disiplinore, në rastin konkret, nga ana e eprorit direkt, pikat 13 deri 20, të VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, i ndryshuar, parashikojnë të gjitha hapat e kërkuar për nisjen e ecurisë disiplinore nga eprori direkt, kur shkelja disiplinore konsiderohet e lehtë; njoftimin me shkrim të nëpunësit, duke e njohur me faktin e pretenduar si shkelje disiplinore; faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedimit disiplinor në ngarkim të tij; si dhe duke i dhënë mundësi nëpunësit të mbrohet, të paraqesë prapësimet dhe prova për të provuar se nuk ka kryer ndonjë shkelje disiplinore me faj.

Vetëm në përfundim të këtij procesi kompleks, eprori direkt në mbështetje të të gjithë akteve të administruara gjatë procedurës së hetimit disiplinor, duhet të marrë një vendim të argumentuar, të mbështetur në prova, nëse nëpunësi e ka kryer ose jo shkeljen dhe në rastet kur ekziston elementi i fajësisë për shkeljen e kryer, jepet masa disiplinore.

Kjo procedurë që duhet të ndiqet gjatë ecurisë disiplinore, e cituar në VKM nr.115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, i ndryshuar, në mënyrë edhe me të detajuar për secilën fazë të saj parashikohet në Udhëzimin nr. 01, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, *“Elementet kryesorë proceduralë dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”*, të cilit organi i disiplinës duhet ti referohet.

Në mbështetje të dokumentacionit dhe sqarimeve të dhëna nga institucioni, rezulton se, eprori direkt i nëpunësit *****, nuk ka ndjekur hapat ligjorë të kërkuar gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të këtij nëpunësi, pasi nuk provohet me dokumentacionin përkatës.

Në këto kushte, Vendimi nr. 132, (nr. 10476), datë 19.09.2022, *“Për dhënie masë disiplinore punonjësve të Bashkisë Vlorë”*, të kryetarit të bashkisë Vlorë, me të cilën i është dhënë masa disiplinore *“vërejtje”*, nëpunësit ***** me detyrë *“Drejtor në Drejtorinë Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”*, mbështetur në germën b), të nenit 109, i

cili parashikon se: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse, është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;...”, si dhe nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të konstatohet si një akt i paligjshëm, nga vetë organi publik i cili e ka nxjerrë aktin dhe ta anullojë atë.

Së dyti, referuar dispozitave ligjore dhe nënligjore, të përmendura më lart, të cilat normojnë institutin e disiplinës në shërbimin civil, në lidhje me pretendimin e nëpunësit, për mungesë të kompetencës së organit dhe shkelje të procedurës së parashikuar ligjore, në dhënien e vendimit “Për lirimin nga shërbimi civil”, nr. 60, (nr.6899 prot.), datë 12.06.2023, nga ana e kryetarit të bashkisë Vlorë, konstatohet se, ky pretendim qendron.

Vërtetohet se ndaj nëpunësit në fjalë ka filluar një ecuri disiplinore nëpërmjet aktit nr.1551 prot., datë 07.02.2023, “Njoftim për fillimin e procedurës disiplinore”, që ka dalë në muajin shkurt të vitit në vijim, e cila ende nuk është përfunduar.

Ndërkohë, nga ana e kryetarit të bashkisë ka dalë akti nr. 60, (nr. 6899 prot.), datë 12.06.2023, për lirimin nga shërbimi civil, për nëpunësin *****, në mungesë të kompetencës së tij lëndore, si dhe në kundërshtim me procedurat e parashikuara për aplikimin e këtij instituti të ligjit, të pasqyruara në këtë material.

Përsa u parashtrua, rezulton se, në këtë rast, kompetencën për të marrë vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimi civil, si masë disiplinore, në bazë të pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, e ka Komisioni i Disiplinës, në këto kushte, akti nr. 60, (nr. 6899 prot.), datë 12.06.2023, i kryetarit të bashkisë, “Për lirimin nga detyra”, të nëpunësit *****, është nxjerrë në mungesë të kompetencës së organit publik dhe në kundërshtim me procedurën, e si i tillë, në zbatim të gurmës a), pika 1, të nenit 108, “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm”, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet të konstatohet si një akt absolutisht i pavlefshëm nga ana e vetë organit që e ka nxjerrë atë.

Ky akt, referuar nenit 110 dhe nenit 111, të ligjit nr. 44/2015, nuk sjell asnjë pasojë juridike, e në këto kushte, vetë organi publik, që në këtë rast përkon me kryetarin e bashkisë Vlorë duhet të anullojë vendimin nr. 60, datë 12.06.2023 dhe të vendosë të rikthejë në pozicionin e tij të punës, nëpunësin *****.

Së treti, sa i përket formularit të vlerësimit në punë, për periudhën 01.07.2022 deri 31.12.2022, të nënshkruar nga kryetari i bashkisë, me të cilin nëpunësi ***** është vlerësuar me nivelin 4 (jokënaqshëm), konstatohet se:

- ✓ Vlerësimi i nëpunësit civil, sipas formatit të miratuar në vendimin nr. 109, datë 06.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, krahas vlerësimit me pikë, përmban detyrimin e plotësimit të

komenteve përkatëse në lidhje me vlerësimin në rubrikat e veçanta dhe atë përfundimtar, arsyet e këtij vlerësimi si dhe rekomandimet dhe vërejtjet e nevojshme.

Ndërkohë, nga këqyrja e formularit të vlerësimit të nëpunësit *****, konstatohet se, rubrikat e këtij formulari janë të pa shoqëruara me komente në lidhje me vlerësimin.

Për realizimin e një vlerësimi sa me objektiv, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”*, të ndryshuar, është përcaktuar dhe procedura që duhet të respektohet për procesin e vlerësimit të rezultateve në punë si dhe kompetencat për vlerësimin.

- ✓ Në kuptim të pikës 12, kreu II, të vendimit të sipërcituar, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, i cili konsiston në tri faza:
 - Planifikimi, ku zyrtari raportues gjatë 15- ditëshit të dytë të muajit dhjetor dhe 15- ditëshit të dytë të muajit qershor, cakton për nëpunësin civil që do të vlerësohet, objektivat kryesore të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në këtë fazë zyrtari raportues, pra eprori direkt, së bashku me nëpunësin që do të vlerësohet diskutojnë qëllimet e nëpunësit për karrierë, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.
 - Bisedimet e ndërmjetme. Kjo fazë konsiston në takime të strukturuar dhe të shkurtra, të cilat zhvillohen në mes të periudhës së vlerësimit, ku zyrtari raportues takohet me nëpunësin civil dhe vlerëson progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara dhe përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.
 - Vlerësimi përfundimtar, i cili realizohet në periudhën 1 - 15 janar dhe 1 - 15 korrik, konsiston në vlerësimin e përmbledhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet dhe në arritjen e objektivave kryesore të punës, të përcaktuara në fazën e planifikimit dhe të rishikuar gjatë bisedimeve të ndërmjetme.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar për këtë rast, rezulton se, këto faza nuk janë respektuar nga zyrtari raportues.

- ✓ Gjithashtu, referuar Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil”*, kërkohet që, ndarja D, të plotësohet nga zyrtari raportues/ kundërfirmues/ autorizues/ eprori direkt për njësitë e qeverisjes vendore dhe nëpunësi pas takimit për diskutimin e vlerësimit përfundimtar të nëpunësit, detyrim i cili në rastin konkret, nuk është respektuar pasi formulari vlerësimit nuk është nënshkruar nga nëpunësi i vlerësuar, duke i mohuar të drejtën për t’u njohur me vlerësimin dhe për ta ankimuar atë, në rastet kur ka kundërshtime.

Konstatohet se, formulari i vlerësimit në punë për periudhën 01.07.2022 deri në 31.12.2022, i nënshkruar nga kryetari i bashkisë Vlorë, nuk përmban elementët e kërkuar të ligjshmërisë, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civilë”, të Këshillit të Ministrave, në këto kushte, në zbatim të nenit 109, germa b), “Paligjshmëria e aktit administrativ”, të Kodit të Procedurave Administrative, ku akt është i paligjshëm dhe në bazë të nenit 113, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, vetë organi publik që e ka nxjerrë, me një akt të ri me shkrim duhet të vendosë anulimin e tij.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të neneve 108, 109, 110, 111 dhe 113, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

Të paralajmërojë institucionin e Bashkisë Vlorë, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Të anulohet vendimi nr. 132, (nr. 10476), datë 19.09.2022, “Për dhënie masë disiplinore punonjësve të Bashkisë Vlorë”, i kryetarit të bashkisë Vlorë, me të cilën i është dhënë masa disiplinore “vërejtje”, nëpunësit ******, me detyrë “Drejtor në Drejtorinë Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”, mbështetur në germën b), të nenit 109 dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, nga vetë organi që e ka nxjerrë atë.
2. Kryetari i Bashkisë Vlorë, në zbatim të nenit 108, 110 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, nëpërmjet një akti të ri me shkrim, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 60, (nr. 6899 prot.), datë 12.06.2023, “Për lirimin nga detyra”, të nëpunësit ******, duke urdhëruar rikthimin në pozicionin e tij të punës, në të cilin është emëruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar dhe të rregullojë të gjitha pasojat e tjera që kanë ardhur në këtë rast.
3. Formulari i vlerësimit të punës, për periudhën 01.07.2022 deri në 31.12.2022, në mbështetje të dispozitave ligjore germa b), e nenit 109, si dhe nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të anulohet nga ana e vetë organit që e ka nxjerrë atë, pasi nuk përmban elementët e kërkuar të ligjshmërisë së aktit dhe të rregullohen pasojat, duke përsëritur aktin e vlerësimit.

4. Njësia përgjegjëse, pranë Bashkisë Vlorë, duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për kryerjen e veprimeve të mësipërme.
5. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 20 ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.
6. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Vlorë si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha